



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MEDHA

VENDIM

Nr 2, Datë 14.05.2019

Për Dhënien e Lejes për Mbushjen me Ujë për Herë të Parë të rezervuarit dhe Vënien në Ngarkesë të Digës së Hec-it Moglicë.

Në zbatim të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, dhe VKM nr.147 dt.18.03.2004 “Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), në mbledhjen e tij të datës 14.05.2019, mori në shqyrtim kërkesën e Kompanisë Devoll Hydropower Sh.A për dhënien e Lejes të Mbushjes për Herë të Parë, sipas shkresës nr. 2019-Tr-00372 datë 26.04.2019, si dhe Akt-Kolaudimit të punimeve të digës së Hec-it Moglicë.

Objektet kryesore të kësaj vepre janë :

- Diga me mbushje material vendi, me lartësi 167 m, me bërthamë të papërshkueshme prej asfalti.
- Bërthama e asfaltit me trashësi 1.17m në bazament dhe 0.5 m në 50 m e fundit të digës deri në kurorë.
- Kuota e kurorës 654 m m.n.d. Gjerësia e kurorës 8.0 m
- Kuota e nivelit normal të ujit 650m m.n.d.
- Kuota e nivelit të ujit për kalim të plotës llogaritëse Q_{1000} , 650.69m m.n.d
- Kuota e nivelit të ujit për kalimin e plotës PMF, 652, 96m m.n.d
- Vepra e marrjes është vëndosur në kuotën 610m m.n.d
- Skarpatat e digës në anën e sipërme dhe të poshtme janë 1:1.5.
- Volumi total i mbushjeve në digë 4,76 milion m^3 .
- Shkarkuesi sipërfaqësor me tre hapsira ku janë istaluar tre porta radiale 6.0 x 8.75, kuota e pragut të kapërderdhesit të shkarkusit është 643m m.n.d.
- Tuneli i devijimit është ndërtuar në anën e djathtë të shpatit të luginës me gjatësi 572 m dhe seksion tërthor $50.7 m^2$ – kuota e hyrjes 508,8m.
- Tuneli i sipërm i shkarkimit me kuotë pragu 600.45m.
- Tuneli i derivacionit ka gjatësi 10.7km që con ujët në ndërtesën e centralit nëntokësor
- Hec-i Moglicë ka dy turbina Frensis me fuqi të instaluar 171,2 M.W dhe prodhim mesatar të energjisë 448 GW.h
- Volumi i Ujit në rezervuar 378mil/ m^3
- Në digë është vëndosur sistemi i aparaturave të monitorimit që do të japin të dhëna për gjëndjen e digës gjatë ngarkimit dhe në shfrytëzim.

KKDM, mbas paraqitjes së dokumentacionit të Aktit të Kolaudimit të hartuar nga Firma "Taulant" shpk, supervizionin të hartuar nga firma E.B.S dhe raportin përfundimtar të punimeve të hartuar nga firma Limak Insaat.

V E N D O S I:

Të miratojë Akt Kolaudimin dhe të japë Lejen për Mbushjen me Ujë për Herë të Parë të rezervuarit dhe vënien në ngarkesë të digës së Hec-it Moglicë, duke mbajtur parasysh dhe në zbatim sa vijon :

1. Kompania Devoll Hydropower Sh A para fillimit të procedurave të mbushjes me ujë të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Bujqesisë, Ministrinë e Mbrojtjes si dhe organet përkatëse të pushtetit vendor në rajonin e ndërtimit të digës. (Neni 25.pika 2,4 e VKM 147 datë 18 .03.2004).
2. Gjatë mbushjes së ujëmbledhësit të kryhet mbikqyrja e gjithë objekteve të veprës dhe të veprohet në zbatim të Planit të Mbushjes me Ujë për Herë të Parë.
3. Të organizohet mbikqyrja e brigjeve të kupës së ujëmbledhësit, si dhe të jenë përcaktuar skemat e sinjalizimit në rast alarmi.
4. Të vrojtohen fenomenet artificiale sizmike që mund të krijohen nga mbushja me ujë, si dhe lidhja e tyre me objektet, duke mbajtur në vërejtje të gjitha aparaturat e tjera të monitorimit.
5. Kompania Devoll Hydropower Sh A të përgatisë dhe të dorzojë në KKDM Akt Kolaudimin përfundimtar i cili do të hartohet mbas vënies në ngarkesë të plotë të objektit dhe mbledhjes të të dhënave 6 mujore.
6. Në Raportin Teknik 6 mujor, në fund të vitit 2019, Kompania Devoll Hydropower Sh A të dorzojë në KKDM "Rregulloren Teknike të Shfrytëzimit, Mirëmbajtjes dhe Kontrollit të Objekteve". Një kopje e kësaj rregullorje të dërgohet në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ing. Maksim Muci

K R Y E T A R

